

VITI XV, NUMRI 12 / DHJETOR 2011

# FOREVER

HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



MERRY  
CHRISTMAS  
&  
HAPPY  
NEW YEAR!



# Të ngrihemi mbi stuhinë!



**N**ë fund të çdo viti, kam qejf të ndaloj për një çast dhe të reflektoj për gjithshka më ka ndodhur. Çfarë viti i pabesueshëm ishte për Foreverin viti 2011. Ai ishte plot emocione, me rritje, befasira dhe ndryshime. Le të kujtojmë kur shpallëm Rally-in Global, programin e ri Profit Sharing 2.0, apo hapjen e zyrës të FLP në Mongoli. Kam patur mundësinë të takoj kaq shumë distributorë të FLP në mbarë botën, të takohem me drejtuesit më të sukseshëm të FLP dhe me numurin gjithnjë në rritje të menaxherëve „Eagle”. Kam ndarë me ju disa histori të mrekullueshme dhe inspiruese që kam dëgjuar nga distributorët tanë. Pas gjithë këtyre nuk mund tua them se sa i entuziazmuar jam për atë se çfarë mrekullish e presin Foreverin.

Ajo që më ka bërë të jem vërtet krenar në këtë vit që po kalon është ajo që shikoj çfarë ju keni realizuar me gjithë pengesat e mëdha në rrugën e tuaj. Ju përballuat sprovat dhe u ngjitët në majat më të larta që të tjerët në këto rrethana që ekzistojnë nuk do ti kishin besuar. Ju demonstruat forcë dhe vendosmëri dhe ju nuk lejuat që ankthi tju zinte rrugën. Kur të tjerë ndoshta u friksuan, ju e mbajtët kokën lart dhe sytë në mundësitë e pafundme. Ju përcaktuat objektivat tuaja jo duke shikuar poshtë por duke synuar gjithnjë e më lart. Ju më kujtoni shqiponjën, simbolin e madh të Foreverit.

A e dini se shqiponja e ndjen stuhinë para se ajo të afrohet, shumë kohë para se stuhija të shpërthejë! Shqiponja fluturon diku në një vend të lartë dhe pret stuhinë të vijë. Kur vjen stuhia ajo hap krahët, era e rrëmben dhe e ngre mbi stuhinë. Kur stuhia bën kërdinë poshtë, shqiponja gjëndet duke fluturuar mbi të. Shqiponja nuk i fshihet stuhisë dhe nuk përpiqet të iki me vrap prej saj. Ajo thjesht shfrytëzon stuhinë për tu ngjitur më lart. Ajo ngjitet nga era që sjell me vete stuhia.

Shqiponjat nuk kanë lindur me këtë intuitë por edhe me këtë sjellje. Ato nuk e ndërtojnë follenë në vrima apo strofulla ku mund të fshihen. Ato lindin në degët më të gjata të pemëve më të larta dhe nuk u vjen keq për këtë, nuk u tremben sfidave; ato fluturojnë lart dhe larg dhe kur nevoja ua kërkon sulen poshtë si rrufe.

A e dini se shqiponjat kur ecin me kokën poshtë pengohen? Nuk do të mund të thoshim që në tokë ato do të ishin simpatike. Ato nuk kanë lindur për të qënë të tilla, ato kanë lindur për të fluturuar. Dhe a i shikoni kur ato fluturojnë, mënyra si fluturojnë dhe sa lirshëm e plot hirësi çajnë qiejt e pafund? Shqiponja nuk është thjesht një logo i kompanisë Forever, ajo është një mënyrë të menduari dhe simbol i asaj se çfarë mund të bëhemi.

Ky vit na ka sjellë sfida, zbulime dhe ndryshime të reja. Në qoftë se edhe këtë vit e mbyllim në mënyrë pozitive, me mendje të kthjellët, e me zemër të hapur, ne do ti mposhtim të gjitha pengesat.

*Duke përfunduar, të gjithë juve ju uroj festa të bekuara duke ju përshëndetur me historinë e shqiponjës, që për mua është jashtzakonisht frymëzues.*

*Ndërsa në agim afrohet një ditë e re, shqipja e vogël përgatitet për fluturimin e parë. Me ankth dhe pak e friksuar pyet Shqiponjën e Urtë Plakë:*

*„Deri ku mund të shkoj?*

*„Aq sa të shohin sytë” – i përgjigjet shqiponja plakë.*

*„Sa lart mund të fluturoj?” – pyet shqipja e vogël*

*„Aq sa ti shtrish krahët” – dëgjon përgjigjen*

*„Sa kohë do të mund të fluturoj” – ngul këmbë përsëri vogëlushja.*

*„Pse të duket larg horizonti?” – i përgjigjet shkurt ajo.*

*„Për çfarë largësi mund të ëndërroj?” – pyet prapë vogëlushja.*

*„Aq sa ti mund të ëndërrosh” – i përgjigjet duke buzëqeshur shqipja plakë.*

*„Çfarë mund të arrij?” – vazhdon të pyes zogu i shqiponjës.*

*„Aq sa ke besim” i përgjigjet e urta shqipe plakë.*

*„Deri ku mund të arrij?” – pyet vogëlushja duke ju marrë goja.*

*„Aq sa mund të kesh besim” – i vjen përsëri përgjigja*

*Shqiponja e vogël fillon të inatoset pak dhe si e hutuar pyet përsëri:*

*„Pse nuk u përgjigjes qartë pyetjeve të mija?”*

*„Më beso, po përpiqem të të përgjigjem sipas njohurive të mija më të mira” – i përgjigjet prapë ajo.*

*„Po ti je shqiponja plakë më e zgjuar. Ti duhet të dish gjithshka. Në qoftë se ti nuk mund të përgjigjes për këto pyetje, kush tjetër mund të më përgjigjet? – flet zogu i shqipes.*

*„Ti, – ia pret shkurtë shqiponja e urtë – Askush nuk do të jetë në gjendje të të thotë ty se si do të fluturosh, Apo sa do të ëndërrosh ti. Përgjigja për çdo shqiponjë do të ishte e ndryshme. Vetëm ti e di sa larg mund të arrij. Askush në këtë botë nuk e di se çfarë mundësisish fshihen brënda teje, apo se çfarë ke ti në zemër. Vetëm TI mund të përgjigjes vetë këtyre pyetjeve. E vetmja gjë që përcakton kufijtë e tu është imagjinata jote.*

*„Atëhere çfarë të bëj? – pyet për herë të fundit zogu.*

*Prapë shqipja plakë e mençur vetëm kaq ju përgjigj:*

*„Shiko nga horizonti, hapi krahët dhe FLUTURO!!!*

*Rex Maughan*  
REX MAUGHAN  
I JUAJI PËR JETË





**Z**jarri kërcet në oxhak, jashtë flokët e borës bien lehtë e qetësisht. Po afrohen festat.

Bota ka filluar të kërkojë dhuratat: në ditët, javët e ardhëshme do ti japim dhurata njëri-tjetrit.

Në radhë të parë mendojmë për atë, që çfarë do të marrim. Çfarë kemi merituar dhe kush do të jenë ata që do të na japin dhurata? A mendojnë për ne? Por ndërkohë pason radha e pyetjes tjetër: cilët janë ata që do të marrin dhurata nga ne? Dhe në radhë të parë: me çfarë? Kujt do ti gëzoheshin më shumë pjestarët e familjes, fëmijët dhe të dashurit tanë?

Jetën e konsideroj dhuratën më të madhe, dhe në qoftë se atë mund ta jetojmë në harmoni, me shumë buzëqeshje, në lumturi, dhe këtë të dimë ta transmetojmë drejt mjedisit tonë, atëhere ditëm ti japim kuptim ekzistencës tonë në Tokë.

Për mua dhurata më e madhe është dashuria dhe përkujdesja. Krahas stilit të jetës sonë intensive, duhet të jemi të vëmendshëm edhe për atë, që të mos kalojmë pranë të njohurve pa ju folur , pa i përshëndetur. Të bëjmë gjithshka, që të jemi të hapur drejt botës, dhe këto ndjenja do ti marrim përsëri. Nëse ti jep gjithmonë, pas një periudhe edhe ti do të marrësh, n.q.s. jep diçka të mirë, atëhere ka mundësi, që ti të marrësh akoma më të mirë. Përpiku për atë, që çifte sysh të qeshur; të buzëqeshur; të rrethojnë në familje, si dhe në rrethin shoqëror dhe të të njohurve. Mendoje mirë, që çfarë i thua shokut tënd, dhe si ja thua. A do të vinte mirë, nëse këtë kështu do të ta thonin ty?! E gjithë bota është një dhuratë: dhuratë është jeta jonë, ekzistenca jonë – sa të gatë do ta ketë secili. Në tokë do kalojmë një periudhë të mirë të kohës, prej nesh varet, se si do ta jetojmë. T'ju dhurojmë mjedisit që na rrethon dashuri, fjalë të ëmbla, buzëqeshje, një përkëdhelje dhe natyrisht të mos harrojmë për shëndetin! E rëndësishme, që këtë jeta ta shijojmë të shëdetshëm; ndoshta nuk ekziston gjë më e rëndësishme se kjo në botë. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe produktet tona. Edhe trupin duhet ta ushqejmë, që të jetojë në harmoni me qënien tonë.

Të dhurosh shëndet është një vepër e mirë dhe e urtë njerëzore, për këtë Rex Maughan krijoi për ne të gjitha mjetet, le ti japim më tej dhuratat e tij. Unë – e ndjej – që morra prej tij një dhuratë për gjithë jetën, për të cilën do ti jem përgjithmon mirënjohës, miliona njerëz ka në botë, që i janë mirënjohës për këtë. Ne mund ti japim atij atë dhuratë jo të vogël, që ndjehemi mirë në vetvete, jetojmë në mirëqënie dhe për këtë arsye ditë për ditë ndajmë me të gjithë mundësinë-Forever.

Kjo dhuratë ndodhet atje tek lënda e secilit, ka, nga ata që dinë ta përmbledhin bukur, ka, nga ata që akoma provojnë vetëm hapat e para. Më e rëndësishmja është ajo, që kemi në dispozicion një dhuratë të tillë të jashtzakonshme, që nuk e ka askush tjetër në botë. Faleminderit Rex Maughan, që e ndave këtë dhuratë dikur me mua, dhe që ne, foreversat të mund t'ja japim më tej botës.

Ju uroj të gjithëve festa të bekuara! Përpara FLP!

DR. SÁNDOR MIELESZ  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM





# Nga të gjithë Holiday Rally-it ky më i mirë 2.

**D**ita e dytë në Porec u hap me leksionin e **Zlatko Jurovic**, ish mekaniku i anijeve mendoi se kishte aftësi për më shumë: në sipërmarrjen private filloi me 22 të punësuar, por në situatën e krizës edhe ajo falimentoi. Pas këtyre hyri në dy rrjete MLM dhe shpejt arriti nivelin e menaxherit, por Foreveri ishte e para, sepse në strategjinë e saj nuk gjeti të meta. Tek ai gjetën mundësinë njerëz të tillë, tek të cilët ndonjë punëdhënës nuk kishte patur besim. Sot gati të gjithë janë menaxherë. Në qoftë se të thonë, nuk je i përshtatshëm për atë, mos e beso” – na siguron ai pastaj na tregon me humor historinë e ndërtimit të rrjetit. „Në Forever bëhesh njeri më i mirë, dhe në zemër ke paqe- por vetëm në qoftë se dëgjon diamantët” – e mbyll fjalën e tij Zlatko.

Lektori që pasoi ka ngjitur Malin e Bardhë dhe Kilimanxharon, dhe në të dy ka ngritur flamurin e Foreverit. Ndryshe mund të themi e nisi nga thellësia por mbrriti në majë. Çfarë mund të na thoshte tjetër titulli i leksionit të menaxherit zafir-diamant „Objektivat dhe motivimi i brendshëm. Roberti na tregon pse është e rëndësishme që të jemi këtu, por pret që të pyesim edhe veten. Sikurse thotë, mungesa e përqëndrimit të shkoq energjitë, po kështu edhe në qoftë se mendojmë vetëm problemet. Ndërsa po të flasim për objektiva, të mos na vijne në mend vetëm paret- sqaron ai – mbasi paret janë mjet primar dhe vetëm qëllim sekondar. „Kur mendon gjëra të mëdha, vijne gjëra të tilla që as i ke menduar” – thotë Róbi, pastaj na tregon se me bashkshorten presin bebin e dytë , gati 7 muaj pas lindjes të të parit., pastaj lektori u përkushtohet gjërave të mëdha: bën betimin dhe pohon se në Korrik të 2013 do të arrij diamant në biznesin e FLP. Shëmbullin e tij e ndjekin shumë të tjerë, bashkpunëtorët me radhë numurojnë objektivat e tyre.



**Róbert Varga** pasohet nga një personalitet tjetër, nga soaring **Tamás Budai**. Punën në Forever ai e shikon sin ë një skuadër të madhe sporti. „Asnjë rajon nuk është kaq i mirë sa ne. kemi lundruar bashkë dhe tani ka ardhur momenti që të arrijmë rritje kaq të madhe , nga e cila bota të çuditet. Dhe kjo rritje varet nga ti, dhe ky nuk është vrap sportiv, kjo është punë, duhet të arrish të sponsorizosh njerzit. Unë mund të çaj edhe botën, por i vetëm jam i vogël, prandaj ju lutem që ato 22 mijë pikët e nevoshme tia bëjmë si një surprizë Rexit!”

Se si mund të lundrohet në çift këtë e mësojmë nga **Andreja dhe Tomislav Brumec**, nga çifti slloven që për disa muaj u bënë zafir menaxherë. „Kur FLP ma ktheu praptas jetën, por në kuptimin e mirë, që nga ajo kohë kam njohur shumë njerëz dhe për këtë e quaj veten me fat- thotë Tomo. Mendimet na drejtojnë ndjenjat, këto vibrojnë, lëshojnë energji, prandaj ka rëndësi se lloj ndjenjash e lejon vetes. Por mos u merr me atë se çfarë mendojnë të tjerët për ty, por vetëm me atë se çfarë mendon ti për veten. Unë e vras mendjen që të gjej njerëz më të mirë dhe e di se sot nuk jam i persosur, por shikoj ndryshimet nëpër të cilat kam kaluar. Faleminderit i them vetes, që qesh në gjendje ta kap këtë mundësi.” Tomislavin e pason në skenë një grua që shkëlqen vërtet, përfaqesja e kozmetikës Sonya, por njëkohsisht edhe soaring menaxhere. **Tünde Hajcsik** „përfaqson biznesin nga brenda dhe nga jashtë” sikurse e formulon ajo. Dhe tërhiqet me shumë modesti në sfond që të drejtojë vëmendjen tek paletat e produkteve. Markën e emërtuar **Rexi** sipas emrit të vajzës së tij. „Sonya na bën të mundur që marrim nga vetja maksimumin, atë bukur për të cilën jemi – thotë Tünde , pastaj flet për rolin e saj për trajtimin e lëkurës, për trajtimin e bukurisë dhe për higjenën: „ në shikimin që vendos që në shtatë sekondat e para, se si ndikojmë tek të tjerët dhe për këtë duhet të shikojmë çdo detaj të imët. Në qoftë se njerzit e shohin ndryshimin cilësor, nuk duan ti ndërrojnë me produkte të tjera.Përveç që marrin një mjet që i bën më të shëndetshëm, më të lumtur, më të lirë dhe më të ekuilibruar. Sa të jetë Foreveri, ata do ti gjesh brenda- kjo është motoja e soaring menaxherit **Sándor Tóth**, mjeshterin e prezantimeve të produkteve në familje. Para se të kalojë sferën praktike na tregon pse është me interes të mësosh kleçkat e ndërtimit të biznesit. „Kjo është jeta jonë:udhëtojmë, miqsohemi me njerëz dhe ndërkohë ndihmojmë të tjerët.” Sipas Sándorit, dy pyetjet më të rëndësishme janë pse dhe në çmënyrë mund ta bëj – këtë duhet të sqarojmë, para se ti futemi kësaj pune. Pastaj duhet të gjejmë ata njerëz që kanë interes, që duan suksesin dhe lumturinë. Dhe sigurisht duhet të perqëndrohemi tek e tanishmja, mbasi kur merremi me të shkuarën apo edhe me të ardhmen, harxhojmë kot energjitë tona. „Të gjithë jemi njerëz të thjeshtë, atë që kemi arritur ne mund ta arrish edhe ti. Vetëm guxo të rezistosh, të pyesësh dhe në qoftë se bën diçka, o bëne mirë o mos e bëj fare – thotë Sandori dhe sikur këtë punë ta fillojmë ta realizojmë tani, fillon nga bazat e njohurive praktike dhe prej tij përfistojmë metoda të thjeshta dhe që mund të kopjohen.



Në gjurmët e tyre tani vjen brezi i ri, vajza e njërit nga çiftet më të sukseshme, menaxherja **Zsanett Gidófalvi**, e cila punon jo që të shtyhet nga pas nga prindërit, por për tu ngjitur me forcat e veta. Sigurisht, është një avantazh që në moshën 10 vjeçe të jesh e rrethuar nga idetë e ndërtimit të rrjeteve, por një mbështetje e sigurtë, nuk do të thotë që menjëherë lidhesh me të –

thekson **Tibor Lopicz**. Zsanettit befasi i mbushen sytë me lotë: „vërtet është fare e thjeshtë, por vetëm duhet vënë në praktikë” – thotë ajo „Duhet të çlirohemi nga zakonet tona të këqia, ti mposhtim ato, dhe dit pas dite të ndryshojmë mbi to. Kjo sigurisht ecën vetëm në qoftë se dëgjojmë në mënyrë selektive, domethënë të mos dëgjojmë njerzit negativ.” Dije se jen ë vënd shumë të mirë dhe bëje mirë atë që bën. Gjithshka mund të mësohet në këtë sipërmarrje, por ka nevojë edhe të heqësh dorë nga disa gjëra, të mund të sakrifkohesh, por s’ka gjë sepse mbas 5 vjetësh do të kesh kohë për gjithshka! Vetëm bëhuni lojtar skuadre dhe në fillim bëjeni vetë!”

„Në jetë gjithshka përbëhet nga ndryshime” – e fillon fjalën e saj soaring menaxherja

**Dragana Janovic**. Ndodhin kriza, shpërthejnë vullkane, bien tërmete: pra gjëra tek të cilat nuk mund të ndikojmë. Por nga ne varet a, se si i shikojmë këto fenomene, në mënyrë pozitive apo negative. Ndrysho dhe fillo të

punosh në të mirën tëndë!” Sipas saj, trendi i shek.21 është që në vend të pasigurisë të mendosh vetë. Edhe ajo vetë la pas një vënd pune të nivelit të lartë për hir të Foreverit.

„Gjithkush mund ta nisë këtë punë, nuk ka kërkesa të veçanta dhe kushdo mund të arrijë kudoqoftë” – nënvizon ajo

Senior menaxheri **Safet Mustafic** e ka përmendur disa herë që për tërë jetën do ti jetë mirënjohës bashkshortes, që firmosi pa atë formularin e regjistrimit. Tanimë besimi ndaj produkteve ishte krijuar, por lidhur me ndërtimin e biznesit ishin të përmbytur. Por sikurse thotë, në firmë për çdo pyetje kishte përgjigje. „Gjithmonë vetëm përcakto objektivat e ardhshme dhe ndiq hapat që ke përcaktuar” na thotë ai „Unë e dua me gjithë zemër FLP dhe njerzit e ndjejnë këtë. Merrni thellën sa më të madhe nga ai kek që firma ju ka ofruar”. Shembulli i Mustafic është për të tjerët, por sikurse thotë, edhe për atë ishte e rëndësishme që dikush kishte kaluar në këtë rrugë më përpara. „Mos prisni për momente të favorshme, sepse dita e sotme është çasti më i mirë” e mbyll ai fjalën e tij.

Historinë e zafir menaxheres **Ágnes Krizsó** shumë vetë e njohin. Është ajo që megjithë disa herë e filloi gjithshka nga e para, sot është drejtuese e një rrjeti që shtrihet në disa



vende. Ka 19 vjet që ndërton biznesin MLM dhe Kroacinë e konsideron atdheun e dytë. Njëherashi nënë dhe drejtuese – shumë energji i dhanë, që dy vajzat pranuan sakrificat, me të cilat shoqërohet kjo punë. „Si nënë kam zhvilluar një betejë të fortë” – thotë ajo pastaj na tregon se si mundi ti mbronje nga efektet negative që vijnë nga mjedisi. Kështu e mendon, ndërtimi i një rrjetinë vetvete është pak: duhet krijuar një rrjet i qëndrueshëm, me gjërësinë dhe thellësinë e duhur, dhe ndërkohë duhet të dimë si të përballojmë rreziqet, sepse ato ndeshen në këtë luftë që bëjmë.

Agnes thotë se në qoftë se ndeshim ndonjë pengesë në realizimin e endërrave edhe ato vetëm ne mund ti mundim. Por këtu, nga të gjithë kanë ardhur më të mirët, që duan të mësojnë dhe e duan këtë profesion, sikurse thotë zafir menaxherja elegante.

Mbështetje ka artilerinë e rëndë: **Veronika Lomjanski dhe Miklós Berkics**. Dy personalitete të pandalshëm, hovi

i të cilëve i çon në tjetër rrugë njerzit – por që të dy në mjediset e tyre kanë efekt të madh. Sipas Veronikës çështja kyçe është karakteri bazë, por akoma më e rëndësishme është a mund të ndryshosh? Pra kësaj duhet ti japësh kohë dhe primare është a e ke besimin e nevojshëm në vetvete.

„Jam e sigurtë për atë që ju jeni më të mirët dhe bashkpunëtorët tuaj janë bashkpunëtorët më të mirë”. Veronika e di saktësisht se çfarë duhet thënë për motivimin e duhur, sepse që nga moshën 18 vjeçe është marrë me njerzit. „Suksesi varet nga ajo në se je i gatshëm të pranosh gjëra të tilla që nuk janë edhe të rehatshme. Unë për këtë jam shumë e aftë sepse kam vendosur. Që të fitosh para, në radhë të parë duhet respektuar rregullat. Domethënë ... doni apo nuk doni? – dëgjojmë prej saj pyetjen e njohur dhe salla përgjigjet fort: Duam!





Ajo që duan më shumë njerzit është të ecin në gjurmët e diamantit **Miklós Berkics**, të kualifikuar kohët e fundit „Tani mund ta marrë vendimin kush të mundet” thotë maja më e lartë e menaxherëve. Unë jam bërë një me firmën dhe me produktet e saj. Por kohët e fundit çdo qelizë e imja ka ndryshuar, jam bërë plotësisht tjetër njeri”

Një pikë kthese për ndryshim mund të jetë edhe Poreci. thelbi është me çfarë mendimesh ikën prej këtej. Ata që janë bërë drejtues të njohur, as ata nuk janë të ndryshëm, vetëm se kanë besim tek vetja, kur të tjerë mendojnë se kjo nuk ecën. Vetëm ky është ndryshimi!” Sipas Miklós-it nuk mund të presim ndihmësa, sponsora: ti vetë me forcat e tua mund ti ngjitësh nivelet. Por për këtë duhet të jesh këtu. Magjia këtu ishte, pyetja shtrohet, truri yt a ishte këtu! merre me vete në shtëpi këtë që ndjeve këtu, realizoi ëndërrat e tua”.

Me këtë mbyllet seria e leksioneve të fundjavës në Porec, madje Miklós këndon edhe një këngë: „jeta është vetëm e jotja” – dhe fjalët e këngës përshkojnë ndjenjat e gjithsecilit në sallë. Dr Sándor Milesz, drejtor i përgjithshëm ngjitet në skenë, falnderon pjesmarrësit, miqtë dhe grupin e vet. jam i gëzuar dhe i kënaqur – thotë ai – spse „ky Rally ishte i tillë sikurse kisha 6 vjet që e ëndërroja”.





„Nga të gjitha herët, ky ishte Holiday Rally më i mirë, mer isi, me aftësim të diamantëve. tashmë shumë lektorë e konsiderojnë një nder ngjitjen këtu në podium, dhe mua më bëhet qejfi kur disanë mbarim vijnë dhe na falnderojnë.”

**Zsuzsa Petróczy**

# Dhe si shkoi?

„Një bregdet i mrekullueshëm, edhe efekti i mjedisit shërbeu si nxitje, se shumë ishim në sallën e leksioneve. Ishin një gjë e mirë diskutimet e dobishme të anëtarëve të Klubit të Presdidentit, dhe shpresoj që kjo të jetë fillimi i diçkaje të re!”

**Erzsibet Ladák**

„Për ne është një sfidë që gjithnjë të pershtatemi me karakteristikat e vendit, me vëndasit. Tashmë edhe edhe për ne edhe për lektorët ekziston rutina e duhur, jemi njohur me njeri tjetrin. Duke shikuar nga një monitor i vogël i kamerës televizive efekti është ndryshe, por ska gjë. Ne nuk na lejohet të shkujdesemi deri në fund të programit. Dhe nuk mundemi...”

**Sándor Berkes**

„Prej 172 vjet më në fund kishim një verë të tillë të bukur që fillon me vjeshtën. Lektorët na transmetuan energji të tillë, dhe asnjë nuk lanë pa ndjenja. Tani me forca të përtrira nisemi për punën e përditshme, ndërsa unë natyrisht kam planet e zhvillimit për takimin e vitit të ardhshëm!”

**Dr. László Molnár**

„Poreci bëhet gjithnjë e më familjar, më pëlqen kjo atmosferë e brëndshme edhe atëhere kur lodhemi dhe shqetësohemi shumë që gjithshka të jetë në rregull. Është një ngjarje e rëndësishme për mardhëniet midis personelit organik dhe distributorëve të firmës.”

**Bernadett Huszti**



**BUDAPEST 12. 11. 2011**

# Success Day




A shtu sikurse tashmë është bërë traditë, Ditën e Suksesit të Foreverit të Hungarisë në qendrën Syma, le hap parakalimi i menaxherëve të kualifikuar, pasta **Péter Szabó** thërret në skenë soaring menaxheren **Terézia Herman**, që do të drejtojë programin. Së pari ajo falnderon ata që kanë ardhur për herë të parë në një aktivitet të tillë duke u thënë: „hapeni zemrën, që të kuptoni pse gëzohemi”, pastaj përshëndet ata që kushedi për të sajtën herë jetojnë me këto mbresa: „duartrokisni veten për vendimin tuaj”. Pastaj fjalën e hapjes e mban Drejtori i Përgjithshëm, Dr. Sándor Mílesz Sándor, i cili thekson seForeveri ashtu si një ishull në det u jep shpëtim, në mesin e rrethanave të jashtme të vështira. „Ne ecim gjithmonë përpara të tjerëve, thekson **Dr Mílesz**, pastaj prezanton Katalogun e produkteve për vitin 2012, kur për herë të parë janë vendosur edhe foto tre dimensionale.. Ndërtuesit e rrjeteve bashkë me këtë marrin edhe mundësinë që të fitojnë faturat telefonike, ose pikërisht vetë aparatit telefonik celular, ku telefonin e dhjetëmijë Nokia X302 do ta marrë **József Mázás**.






**Dr Boglárka Francia**, gjithmonë ka dashur të bëhet doktoreshë, por ndërkohë ju realizua jo vetëm kjo ëndërr, por edhe të jetë menaxhere në biznesin e FLP. Ajo flet për problemet e shëndetit në stinën e dimrit, që në praktikë ndeshemi shpesh me to, sidomos në organet e sipërme të frymëmarrjes dhe sa na mbrojnë vaksinat apo antibiotikët kundrejt bakterieve e viruseve të llojeve të ndryshme. Natyrisht një zgjidhje ekziston me përdorimin me bollëk të vitaminave dhe lëndëve minerale. Pastaj rreshton „armiqtë” e fëmijve dhe nënave që vijnë nga ushqyerja e dobët apo nga përhapja e smogut dhe gazit, nga obeziteti apo mungesa e lëndëve minerale e tensioni i lartë, por njëkohësisht flet edhe për faktorët pozitivë me se mund tu kundërvihemi këtyre faktorëve të dëmshëm. „Aloe Vera faktikisht është një ushqyes






i lëngshëm me 240 lloje efektshë pozitive” – thotë ajo, pastaj e zbërthen rëndësinë e saj, kur gjejmë cilësi dhe besueshmëri. Aktiviteti vazhdon me kualifikimin e supervisorëve dhe asistent menaxherëve: ku distributorët e kualifikuar plot frymëzim ngjiten në skenë, ndërsa mbas tyre **Dr. Terézia Samu** kirurge e venave dhe soaring menaxhere mban leksionin e saj. Fjala e saj ka të bëjë me peshën, një problem që na intereson të gjithëve dhe ku kontrolli i saj nuk varet nga gjë tjetër veçse nga ruajtja e ekuilibrit të nevojshëm midis marrjes dhe konsumit të energjisë, ku situata në Hungari është e tillë ku 20% e të rriturve është i mbi peshë dhe 40% tepër mbi peshë, dhe gjithnjë e më tepër po bëhet një problem edhe për fëmijët. Mbi të gjitha kjo nuk duhet parë si një problem estetik por si një problem shëndetsor. Nga ky leksion mësuam edhe bazat e ushqyerjes normale, përbërësit e dietave tona, rëndësinë e piramidës të të ushqyerit si dhe shkaqet pse nuk biem nga pesha. Por më e mira ishte ajo që si për të na frymëzuar, në skenë u paraqitën ata që kanë ndjekur këto dieta dhe që kanë rënë nga 5 deri në 20 kile, ndërmjet tyre edhe vetë lektorja.

Ndërmjet dy elementëve të programit, pjesmarrësit i ndezi grupi Diva me hitet e mrekullueshme muzikore të **Enikő Détár, Nelli Fésüs dhe Judit Ladinek**. Pas kësaj vijon kualifikimi i menaxherëve të sapo kualifikuar. László Palanca atë që arriti e quan triumf të qëndresës, dhe për 4 vitet e shkuara falnderon gjithkënd. „Kurrë, kurrë, kurrë mos u dorëzoni!” – buçet fort zeri i tij. „Asnjë çast nuk ofendohem” – e merr fjalën **Veronika**





**Szerdahelyi**, pastaj bën thirrje që ta pasojnë atë sepse në këtë „podium ka vend plot”. Sikundër shprehet ajo „ jemi në rrugën e drejtë, jemi në vendin më të mirë”. Pastaj në podium ngjiten „më të mirët e më të mirëve”, anëtarët e klubit të Conquistadorëve dhe të kualifikuarit për në Rally-in European.

**Tibor Bódi** dhe bashkëshortja e tij **Andrea Lórinicz**, sipas pohimit të tyre, janë vetëm në fillim të rrugës, por tani ata kanë marrë vrull. Çifti që jeton në Szurdokpüspök, nuk i ka tamam dy vjet në këtë biznes, dhe në Korrik u kualifikuan si menaxherë. Tibori kërkoi punë si elektrikist tek **Tamás Budai**, por prej tij gjeti shumë më tepër. „Duhet presion, thotë ai, dhe gënjen ai që thotë se kjo punë është e lehtë. Por në kokë duhet të kesh mbijetesën, sepse vetëm atëhere mund ta bësh realitet.”

Zafir menaxheri **Endre Seres**, është ai që flet për mënyrën e të menduarit globale, për stimulim global Profit Sharing 2.0. Çdo vendi që realizon mbi 3000 pikë shitje i jepet e drejta globale. Ndërsa ai që realizon programin profit Sharing 2.0, ai kualifikohet për Rally-in Global, që përfshin të gjitha takimet e deri tanishme. Pra detyra është dhënë: përgatitja dhe shtimi i drejtuesve cilësorë, si dhe qënia aktive në çdo muaj të kualifikimit „Ki besim tek vetja që të besojnë edhe të tjerët se kjo është e mundshme” – thotë Endre dhe na nxit që të mendojmë gjëra të mëdha sikurse bëri edhe **Rex Maughan**. „Kush je? A je model që të ndjekin? Ne do të vijmë atje po ti do të jesh atje, në Japoni apo në Brazil...ndërkohë edhe ajo vendoset!

Tre tenorët : **Lajos Túri ( Lui), Tibor Éliás dhe Miklós Berkics** këndojnë, bëjnë komedi, japin shfaqje me shpirt dhe të çliruar ashtu si dhe ja vlen të punohet në FLP.





Pas kualifikimit të asistent supervisorëve, flet me shumë pasion lektori i sapo vlerësuar **István Halmi**. Zafir menaxheri Istvan Halmi, disa herë si fëminë pyet: cila është ëndërra jote? „Do të jem milioner, dhe po kështu do të jetë edhe djali që më ngjan mua” – thotë ai, sigurisht nuk i besuan, madje e etiketuan si fëmi i keq. Që nga ajo kohë të dy objektivat ju realizuan, por ai ka përvojën që djemve të tij ju desh të ndesheshin edhe me „hajdutët e endërrave” të cilët thyejnë zellin e të rinjve, sepse thonë që objektivat që i vënë ata vetes nuk janë reale. Istvanit ashtu si edhe të atit i thanë që „mëso, që të bëhesh diçka më shumë se babai yt”. „Nuk e kam pëlqyer këtë thënie, por më shumë u bëra,” thotë sot ai dhe shtjellon rëndësinë e ëndërrave dhe rolin e caktimit të afateve kohore të sakta. „Planifiko, dhe mos prit që jeta të të detyrojë për diçka”. Endërra e tij aktuale është që në këtë vend të ketë sa më shumë njerëz të shëndetshëm, të jetojnë në paqe e dashuri, që fëmijve tu japin jo punë por jetë të mirë. Pjesmarrësve ju uron suksese, dhe suksesin ta përcjellin më tej. „Dhe të mund të realizoni ato që ëndërroni” – është mesazhi i tij përmbyllës.







## TË KUALIFIKUARIT 10. 2011

BRANISLAV BRAČANOVIĆ & MARIJA BRAČANOVIĆ	DR. ROKONAY ADRIENN & DR. BÁNHEGYI PÉTER
DOBAI LÁSZLÓNÉ & DOBAI LÁSZLÓ	SENK HAJNALKA
DRAGANA JANOVIĆ & MILOŠ JANOVIĆ	DR. SERESNÉ DR. PIRKHOFFER KATALIN
ÉLIÁS TIBOR	& DR. SERES ENDRE
DR. FÁBIÁN MÁRIA	SIKLÓSNÉ DR. RÉVÉSZ EDIT
GULYÁS MELINDA	& SIKLÓS ZOLTÁN
HAIM JÓZSEFNÉ & HAIM JÓZSEF	SONJA JUROVIĆ & ZLATKO JUROVIĆ
HAJCSIK TÜNDE & LÁNG ANDRÁS	STEVAN LOMJANSKI
JADRANKA KRALJIĆ-PAVLETIĆ	& VERONIKA LOMJANSKI
& NENAD PAVLETIĆ	SZÉKELY BORBÁLA
KÁSA ISTVÁN & KÁSA ISTVÁNNÉ	SZERDAHELYI VERONIKA
KLAJ ÁGNES	SZOLNOKI MÓNICA
KÚTHI SZILÁRD	TANÁCS FERENC & TANÁCS FERENCNÉ
MÉSZÁROS JÓZSEF	TÓTH LÁSZLÓ & TÓTHNÉ PÉCZER ERIKA
DR. MOLNÁR LÁSZLÓ	TÓTH SÁNDOR & VANYA EDINA
& DR. MOLNÁR-STANTIĆ BRANKA	TÓTH ZOLTÁN & HORVÁTH JUDIT
DR. NÉMETH ENDRE & LUKÁCSI ÁGNES	VARGA GÉZA
OROSHÁZI DIÁNA	& VARGÁNÉ DR. JURONICS ILONA
PALANCSA LÁSZLÓ & SPRINGMANN ANDREA	VARGA RÓBERT
RAJNAI ÉVA & GRAUSZ ANDRÁS	& VARGA-HORTOBÁGYI TÍMEA



# PASQYRA E *Dhjetorit*

**J**anë të shumtë ata që nga Dhjetori, presin surpriza, dhurata, mrekullira, shpresa të një jete më të bukur. Besojnë se Dhjetori do ti çlirojë ata nga gjithshka, nga ajo që për ta ka qënë e keqe, do ti fshijë ëndërrat e porealizuara, e punët e pambaruara, dhe Viti i ri do tju sjellë ndryshime. Dhjetorin e konsiderojnë një letër fati, Jolly Joker, me të cilin mund të shpjegohet, mund të ndryshohet, mund të çbëhet apo të quhet hiç gjithshka që nuk e bëmë, që nuk e planifikuam dhe që nuk e arritëm.

Por për shumë të tjerë ky muaj do të thotë një ballafaqim i pakëndshëm. Këta janë ata që i shpegojnë me pengesat që u kanë krijuar pse dhe si nuk i kanë realizuar gjerat. Kërkojnë mëkatarët, pretextet dhe shpesh gjenë „rrethana të vërteta objektive, të pavarura nga ata apo që janë në dorë të forcave madhore”. Ata e kanë bërë zakon të thonë, janë situata të vështira ekonomike, nuk kanë pare njerzit, është mbushur tregu, tani këtë biznes e bëjnë edhe shumë të tjerë, edhe të tjerë e kanë lënë, edhe të tjrëve u ka rënë xhirua... Këto janë ato që quhen argumenta subjektive, vetëtrullosëse.

Ka një kamp tjetër të fuqishëm, që në Dhjetor bëjnë bilancin rezultateve të vitit forever, një vit tërësisht fantastik, plot me mbresa dhe entuziazat. Këta janë ata që, tashmë që në fillim të vitit, në mënyrë të planifikuar, të paktën çdo ditë kanë punuar nga 4 orë, bënë trainime, fiksuat në fletore objektivat e tyre, se çfarë dhuratash duan, dhe jo tua japin të tjerët por ti siguronë vetë për festat e Dhjetorit. Ata bëjnë llogari sa bashkpunëtorë të rinj, konsumatorë apo sipërmarrës, kanë gjetur, sa prej tyre janë kualifikuar në nivelet e marketingut, cilët arritën Eagle menaxherë, kush u bë anëtar i Klubit të Conquistadorëve, sa distributorë të rinj morën pjesë në takimin europian të Vjenës apo në Rally-in botëror të Washingtonit, sa shkuan në pushimet e Porecit kroat, sa vetë morën vetura nga Foreveri apo çequet Profit Sharing nga Rex Maughan, me sa mijë Euro u rritën të ardhurat e tyre. Po vjen Dhjetori i 15-të për FLP e Hungarisë dhe të rajonit, viti i 15-të i mbylles me sukses. FLP edhe këtë vit bëri histori. Xhiroja tashmë për 34 vjet radhazi u rrit. Firma hodhi në treg produkte të reja të mrekullueshme, FLP është hapur në shtete dhe rajone të tjera, dhe u krijua një sistem i ri global i Foreverit. Të 150 vëndet ku është FLP janë përfshirë në një rajon unik botëror. U zgjerua dhe ripunua politika e biznesit të FLP, e cila anëtarëve të Foreverit u krijon mundësi të pakufishme.

Edhe në të ardhmen do të do të ketë Dhjetora. në qoftë se ky i tanishmi ndoshta nuk të pëlqen edhe aq, ke mundësinë prapë të jesh i lumtur, gëzoju mëgjezeve, çdo çasti, sepse sa je i gjallë mund të veprsh. Gëzoju shpëtimtarit, siguro veten dhe të tjerët, merre vetë përgjegjisinë për vete dhe për familjen tënde. Ki besim dhe futju këtij biznesi që jeta dhe e ardhmja jote të mos varen nga ato gjëra që shikon në televizor, në radio, në gazeta si show të realitetit. Stakoju nga gjithë kjo këto dhe bindu se mendimet e tua, planet e tua, puna jote në Forever dhe forca e besimit tënd janë më të fuqishme se „e vërteta objektive” bajate, ordinere, alarmuese dhe e stërthënë.

**Tibor Radóczki**  
Soaring menaxher, Drejtor rajonal



DRAGI KEDVES ÚJ SASOK! DRAGI NOVI ORLE!  
DRAGI NOVI ORLI! NOVI ORLE!  
POŠTOVANI NOVI ORLE!

DITË SUKSESI

# Success Day

NË DITËLINDJEN E 12-TË



DITËT E SUKSESI TË MOTIVOJNË, TË FRYMËZOJNË, TË MBUSHIN ME ENERGI. LEKSIONE TË SHKËLQYERA, MIQËSI, GËZIM QË VJEN NGA NIVELET E ARRITURA: TË GJITHA SË BASHKU I BËJNË KËTO RASTE TË VEÇANTA. DHE KUR NË NJË DITË TË TILLË FESTOJMË EDHE DITËLINDJEN E 12 TË FLP-S SË KROACISË, KJO NDJENJË TË JEP MË SHUMË ENTUZIAZËM.

**T**ë armatosur me Gél, buzëqeshje dhe hare përshëndesim drejtuesit e programit, **Tea-n dhe Edvard Badurina-t**, çiftin e ri manager nga Rjeka. Kanë një vit e gjysëm të lidhur aktiv në ndërtimin e rrjetit, por ashtu sikurse thonë, kjo do të jetë puna për gjithë jetën e tyre.

Pas përshëndetjes së miqve dhe bashkpuntorve, ftojnë në skenë çiftin e shpallur shumë herë kampion në Kroaci në kërcimin latino-amerikan, **Gabrijela Pilićet dhe István Varga**. Krijuan një atmosferë të shkëlqyer me cha-cha-cha dhe paso doble. Pas bllokut argëtues, drejtori rajonal për Kroacinë, **Dr. László Molnár** i përshëndet të gjithë me rastin e ditëlindjes, përshëndet mysafirët, **Dr. Sándor Mílesz** drejtorin e përgjithshëm, **Ágnes Krizsó** manageren safir, çiftin Kepe nga Sllovenia, drejtuesin manager slloven **Jožica Zore**, **Dr. Sonja Jović**, mysafirët e ardhur nga vendet fqinje dhe distributorët kroatë të ardhur për të festuar. Drejtori i përgjithshëm **Dr. Sándor Mílesz** përshëndet nga skena me rastin e përvjetorit, por ajo ka edhe një arsye, që për momentin ne kemi rritjen më të madhe në xhiro në të gjithë rajonin. Shkakton gëzim edhe me lajmet e reja: ndryshon politika e biznesit në të mirën tonë. Pas kësaj produktet mund të shiten edhe në ato vende, ku deri tani nuk ishte e mundur. Dr. Mílesz mbyllje i uron Kroacisë, që të vazhdojë punën me tempon e tanishme, dhe së bashku me rajonin të jetë e para në Europë.



**Dr. Milesz dhe Dr. Molnár** së bashku fryjnë qirinjtë e tortës së ditëlindjes, më pas drejtuesja e zyrës kroate lexon telegramin përshëndetës të **Veronika dhe Stevan Lomjanski-t**. Andrej Kepe, drejtori rajonal për Sllovenin përkthen urimet e mira për distributorët sloven.

Në vazhdim të programit mundëm të dëgjojmë leksionin e **Dr. Sonja Jović** me titullin „Shëndet me ndërgjegjësi“. Sonja thotë që FLP-ja është mishërim i shëndetit me suksesin. Por ndihmë mund t'ju jepet vetëm atyre, që të lejojnë. Ne vetë i formojmë njohuritë tona. Është i rëndësishëm qëndrimi si edhe predispozita për mbrojtjen e shëndetit. Të mos harrojmë: sëmundjet në realitet lindin nga mungesa e mjaftueshme, ndërsa fiziologjikisht nga mungesa e ekuilibrit, në të njëjtën kohë duhet të përkujdesemi edhe për shëndetin social. „Ne e meritojmë shëndetin, dhe kemi me se ta sigurojmë atë“ – përfundon fjalët Dr. Sonja Jović.

**Selma Belac** managere nga Rjeka tregon rrugën deri në nivelin e manager-it. Jeta para FLP-s mezi futej në pak rrjeshta. Tregon me çfarë është marrë dhe që gjithmonë ka punuar me ndershmëri, por nuk mundi të përparonte. Është natyrë e pastër dhe komunikuese, por asnjëherë nuk e vlerësuan për punën. Më në fund erdhi pika e kthimit: njohu **Jadranka Kraljić Pavletić-in**, sponzorin. Pasuan shumë prezantime, shumë mësim, fillime suksesesh, pastaj gjendje amullie. Por Selma është luftëtare e vërtetë, me ndihmën e Dario-s bashkëshortit dhe me çmimin e të mësuarit shumë u bë e suksesshme. Falë Foreverit ëndrrat i bëri realitet dhe do vazhdojë ti bëjë edhe në të ardhmen.

Going Global është gjë e re në FLP. Të përparojmë globalisht – shpjegon esencën e parrullës **Dr. László Molnár**, drejtor rajonal për Kroacin. Takimet e mëdha do të jenë më të rralla: nga 2013 do të jetë vetëm një rally, Global Rally. Do të jetë i vetmi takim jashtzakonisht i madh, në të cilin do të duam të gjithë të marrim pjesë: kjo mund të merret me mend. Kështu na mbetet më shumë kohë për ndërtimin e rrjetit. Disa do të përpiqen pastaj, që të kenë më shumë rezultate dhe kështu të mund të takohen me të tjerët në këtë rally më të madhë dhe më të mirë. „Përdorini këto mundësi, paratë dhe produktet, sepse sjellin një gjendje të përgjithshme të mirë. Dhe të gjitha këto – i siguron për ju- firma më e mirë në botë, Forever Living Products – thotë dr. László Molnár.

Rradhën e merr manager-i i sapo klasifikuar, Alen Lipovac sportist dhe sipërmarrës. Tregon se si mund të lidhen bashkë besimi dhe dashuria me Forever-in. Parimet drejtuese bazë të firmës janë mirkuptimi, respekti, guximi por edhe argëtimi. Ndërsa njeriu modern e kërkon mirqënien pa njohuri, pa punë dhe pjekuri. Megjithatë ne na duhet të jemi të virtytshëm. FLP-ja bën të mundur, që të fitojmë mbi vetveten, të gjejmë ekuilibrin dhe





zgjdhje në jetët tona. Firma na ofron shëndet dhe para, por krahas tyre edhe vlera morale – tashmë 34 vjet dhe në 157 vende.

„Duhet besuar në produktet, duhet besuar në vetvete, tek njerëzit, duhet besuar tek suksesi.

Derisa besojmë kemi gjetur rrugën” - thotë Alen.

Vazhdojnë klasifikimet. Të klasifikuarit assistant managerë, managerë, distributorët në top 10, eagle managerë si dhe fituesit e programit promovues për makinë marrin shpërblimin nga dora e Dr. Sándor Milesz. Skena u duk e vogël nga shumë të klasifikuar dhe sponsor, nga bashkpuntorë që donin të fotografonin. I përgëzojmë më të suksesshmit!



Radhën e ka leksioni i asaj zonje , që para 11-vjetësh ju fut biznesit të FLP-s, dhe që nga ajo kohë grumbullon sukseset njëra pas tjetrës. Bashkë me të shoqin janë në nivelin e senior manager-it. Leksionin e hap kështu: duhet të shohim, atë që është më afër nesh, dhe kjo është familja, e cila jep forcën më të madhe. Kur **Jadranka** u njoh me FLP-n, mundësin ja ofroj menjëherë familjes dhe miqve. Forcë morri nga Tihomir-i, sponsori i saj, si dhe nga produktet e FLP-s. Mësoi shumë në trajnime. „Forca fshihet atje tek lektorët, bashkpuntorët, por forca më e madhe është tek solidariteti” - thotë zonja senior manager-e. „Nuk ka nevojë të kopjoni të tjerët, vetëm jini pjesë e skuadrës dhe ndiqni ata, që sheshojnë rrugën drejt suksesit”.

Një kohë kisha pengesa plot, të cilat u përpoqa ti zbut me veprime kompensuese. Më duhej të garantohesha që jam dikushi. Kishte edhe objektiva jo realë! Nga një material trainimi MLM vazhdimisht dëgjoja: sillu, mendo dhe jeto si një DIAMANT! Gjithshka e bëra për këtë, pastaj në fushën e shpenzimeve... Mblodha borxhet dhe thashë, po do të jem edhe unë i pasur. Biznesi i FLP (kur mu afrua sponsori im Zsolt Leveleki) mua më gjeti në pikën më të ulët të jetës time, materialisht, fizikisht dhe shpirtërisht. Duhej të vendosja: Jam prej çeliku apo marmalatë? Do të jem viktimë apo do të mbijetoj? Vendosa të luftoj, ishte një lodhje e madhe, por ia vlejti! Pastaj kur shleva borxhet, befas mbaroi njëri nga objektivat, pushoi së ekzistuari motivimi për para. Çdo muaj fitoja miliona, nuk ishte ndonjë problem hoteli me pesë yje, një turne në

një bregdet. Kur zgjohesha, po binte shi thërrisja aeroportin. Ka nga ata që për weekend shkojnë pronat e tyre në fshat, unë një vrap në ishujt Kanari. Por kjo po i çonte në një drejtim të gabuar vlerat e mija; doja një objektiv me më shumë përmbajtje. Po kështu njerzve nuk u intereson sa distiktive ke ti. Por edhe me të ardhurat mund të krijosh një antipati. Vetëm me shëmbullin personal mund të ndikosh, dhe me atë se çfarë njeriu je dhe si sillesh me të tjerët. Ky biznes të mëson që të jesh gjithmonë modest!

### **Çfarë parashikon për këtë biznes për Hungarinë dhe për rajonin?**

Nuk mund të jemi të pavarur nga situata e krizës botërore, këtë duhet ta pranojmë. Në qoftë se ulet niveli i shoqërisë, kjo ndikon në gjithshka. Detyra jonë është që njerzve tu japim besim e shpresë dhe me këtë besim e shpresë në radhë të parë duhet të mbushim veten. Tregu përsëri do të rindahet; përsëri do të piqet torta-FLP dhe unë jam shumë gojëëmbël!

### **Ke kohë për miqësi?**

Dashurinë time nuk e mat me pikët, kam shumë miq, që nuk janë në FLP, madje ka edhe nga ata që nuk i përdorin këto produkte. Por meqënëse se tani jam shumë i zënë „me objektivin” nuk kam kohë të tepërt që të flas me këdo dhe përgjithshka. Me mua tani vetëm për Foreverin mund të bisedohet!

### **Kështu do të vazhdosh për një vit e gjysëm?**

Nuk kujdesem që të çlodhem. Tash psh në fund jave janë ditë për familjen, shkojmë në kinema, hamë darkë, zgjohemi, kur zgjohemi jemi bashkë të katër me Timin,





me Bendeguzin por edhe me banorin e vogël 4 muajsh në barkë të nënës.

**Për këtë sigurisht ke nevojë edhe për mirkuptimin e bashkshortes. Ç'thotë ajo për planin tënd diamant?**

Natyrisht që kemi rënë dakort. Situata eshte e tilë shefi im është afati, shumë punoj, por atëhere kur unë dua. Bashkshortja më ka kuptuar, që në qoftë se do të rri gjithë kohën në shtëpi, nuk do të eci përpara. Mua më duhet loja, detyra, sfida. Ia vlen të punosh në biznesin e Foreverit, ta kalosh kohën me Foreverin!



**Një sfidë do të jetë edhe vënia e emrit të foshnjës që pritet të lindë. Bendeguzi në Maj pret motrën.**

Me një vajzë nuk do të mbetemi, kemi planifikuar maksimumi 10 fëmi (qesh). Të jesh baba është një gjë e mrekullueshme, kërcëj vrap nga krevati kur e dëgjoj në mëngjez që është zgjuar. Mezi pres ti bëj banjë, të luaj me të, ti ndërroj pelenat. Eshtë një fëmi i qeshur, i qetë, që luan, që miqësohet, edhe ai do të bëhet një ndërtues rrjetesh marketingu. Sigurisht do të na ketë pranë, mund të mbarojë universitetin, mund të marrë një profesion „civil”, por në Forever të gjitha i ke; mund të shetitësh botën, të vendosësh mardhënie kulturore, nga pikpamja sociale të jetë më i ndjeshëm, të mund të mësojë, të zhvillohet, ndërkohë që është i lirë dhe

me pavarësi materiale. Pra do të bëjmë gjithshka që me shëmbullin e mirë ti prijme përpara, por do ta lëmë të vendosë vetë. Për hir të sigurisë, tashmë mbledhim fotot e FLP, që të ketë një ekspozitë, në qoftë se Bendegúz Varga-n do ta thërrasin në podium si diamant menaxher të FLP, dhe sigurisht nuk do të jetë ndryshe as me fëminë tjetër që po vjen në jetë.

**Cilat do të ishi këshillat tuaja më të rëndësishme për një që fillon në FLP?**

Të mos mendojë shumë për ata që hezitojnë, jo me çdo kusht do ti bësh ata të të kuptojnë, dhe jo gjithkush do të futet në këtë biznes. FLP tash është e garantuar, produktet janë në nivelin më të lartë. Të kërkojmë atë njeri që do diçka dhe tash ai ta provojë atë.

**„NUK KA BIZNES MË MIQSOR-FAMILJAR SE SA KY I FLP”**

**Timea Varga-Hortobágyi**

„Dikur para 11 vjetësh u takova me Robin në FLP. Pastaj kaloi një kohë e gjatë, kur u risponsorizova rash përsëri në grupin e Robit. Nuk qe e qëllimshme, por ja që ndodhi. Kemi 3 vjet bashkë, një vit e gjysëm të martuar. Për mua nuk ka ndonjë dallim midis bashkshortit dhe rrjetndërtuesit, ai është i tëri „vagarobi” që përkushtohet plotësisht me mish e me shpirt sin ë shtëpi dhe në FLP, dhe për këtë e dua shumë. Nuk mendoj se biznesi na privon nga diçka, përkundrazi Foreverit duhet ti jemi shumë mirënjohës, për mardhëniet tona, për jetën tonë. Kam qënë shumë e rehatuar që Robi për një vit mundi të qëndronte me ne, për sa kohë isha me barrë dhe kur Bendegúz ishte i vockël. Kur kthehet në shtëpi na tregon gjithshka, bisedojmë për çka bërë nga FLP dhe pastaj në plan të parë del familja. Çdo javë ka dy-tre ditë që rrimë bashkë dhe atëhere flet vetëm për ne. Robi ngrihet e shkon te Bendeguzi, e ushqen, luan me të dhe unë në atë kohë pushoj. Eshtë një Baba dhe Bashkshort shumë i mirë. Punon shumë, por këtë bashkë e kemi biseduar sepse ecim drejt një objektivi të përbashkët, ka të bëjë me jetën tonë. Dhe më duhet të them se biznes më miqsor-familjar nga FLP nuk ka. Çfardo objektivi cakton njeriu vetes, apo nevojën që ka për para, ky biznes mund tja japë...sepse edhe për gjëndjen shpirtërore duhet edhe gjëndja materiale. E pranoj që ky është biznesi i Robit ndërsa unë jam lojtar në prapavijë. Ai ka shumë qejf të luajë rolin që ka,, të japë leksione, ndërsa unë kam qejf ta dëgjoj. E adhuroj të qënit mama, ky yni është vogëlushi më i mirë në botë. I qetë, i duruar, gjithmonë i qeshur dhe shumë i ekuilibruar- edhe të rriturit mund të mësojnë shumë prej tij!”




**ALOE BODY  
TONER**  
Washing and  
moisturizing cream  
NET WT. 4 OZ. (113g)

**ALOE BODY  
CONDITIONING  
CREME**  
NET WT. 4 OZ. (113g)

**ALOE  
BATH GEL**  
NET WT. 4 OZ. (113g)





## Përdore kështu!

Në rastin e celulitit qelizat yndyrore mbledhen bashkë në indet lidhëse të lëshuara, të cilat kthehen në nyje, më pas zmadhohen, duke ngadalësuar me këtë furnizimin me gjak dhe qarkullimin limfatik. Në këtë kohë limfa e mbushur me lëndë helmuese grumbullohet midis qelizave dhe nëpërmjet kësaj sipërfaqja e lëkurës shndërrohet me gunga, me gropa. Ndryshimi në rradhë të parë mund të ndodhë në bark, në vithe, në këllqe dhe në kofshë. Mbledhja në formë bobine është një nga mënyrat më të efektshme në trajtimin e celulitit. Krahas efektit që ushtron në lëkurë dhe indet lidhëse, zbeh plasaritjet e lëkurës.

### SI TA PËRDORIM BODY TONING KIT-IN?

Sipërfaqet ku mund të përdoret: kofshë, mes, këllqe, diafragmë dhe krahu i sipërm ( nuk mbështjellim parakrahun, kërcirin, kraharorin).

#### HAPI 1.:

Dush me ndihmën e sfungjerit dhe Bath Gelée. Ky ndihmon në largimin e qelizave të vdekura, hap poret duke u siguruar me këtë rrugë të lirë faktorëve veprues.

#### HAPI 2.:

Para lyerjes me Toner rekomandohet masazh me First mbi sipërfaqen që do trajtohet. Ky dezinfekton dhe parandihmon, që faktorët veprues të penetrojnë edhe në shtresat e thella.

#### HAPI 3.:

Vendosim Toner-in me shtresa të holla, me lëvizje rrethore, më pas pjesët e trupit i mbështjellim me celofanin special jo shumë shtrënguar, duke përparuar nga poshtë lart nga gjuri deri te kocka poshtë gjoksit me përafërsi në dy shtresa. Efekti ngrohës i vajit të kanellës dhe specit rrit qarkullimin e gjakut, dhe shkakton hiperanemi. Lëkura ngrohet dhe merr ngjyrë të gjallë. Gjithë këtë duke e mbajtur ngrohtë, e lëmë ashtu për 60 minuta në kushte pushimi. Gjatë trajtimit është i domosdoshëm marrja e lëngjeve. Më i miri në këtë rast është Aloe Blossom Herbal Tea.


#### HAPI 4.:

Largimi i celofanit me fund të ngjitur bëhet me ndihmën e gërshërës. Shplarja e trajtimi nuk rekomandohet në 4-5 orët e ardhshme.l.

Kondicionuesin e Body Toner-it , do ta rekomandoja për përdorim ditor në të gjithë trupin për trajtimin e tij. Nuk rekomandohet në rastet e menstruacioneve, tensionit të lartë, sëmundjeve të sistemit vaskular, çrregullimeve të qarkullimit të gjakut, sëmundjeve tumorale apo shtatzanisë.

**Ildikó Hrnicsjár  
masazhatore**





## -ja e Vitaminave

**E**mërtimi vitaminë e ka origjinën nga biokimisti polak Kazimierz Funk. Vitaminat janë lëndë ushqyese plotësuese, që në përgjithësi nuk formohen në trup, por janë të nevojshme për tu marrë në sasia të vogla për një proces jete normale. Në mungesë të këtyre, në organizim lindin shqetësime të funksionimit (të metabolizmit dhe tretjes), dhe në rastin më të keq edhe humbja e tij. Vitaminat janë përbërës organik, që marrin pjesë në reaksione biokimike dhe që drejtojnë edhe transformimin e energjisë.

Në shekullin e kaluar u bë zbulimi i lëndëve ushqyese të nevojshme për krijimin e energjisë. Së pari ishte Albert Sent György që në vitet 1930 izoloi vitaminën C.

Vitaminat mund të ndahen në tretësira të yndyrnave (vitaminat A, D, E dhe K) dhe në ujë (grupi vitaminave B, dhe vitaminat C, F, P dhe U).

**Optimale** quhet ajo sasi vitaminash, që kënaq në masë të plotë nevojat e e organizmit për vitamina.

Në qoftë se në organizëm merren vitamina më pak se sa nevoja minimale, pas një kohe në organizëm lind mungesa e vitaminave (hipovitaminosis). Shkaqe të kësaj mund të jenë të shumëllojshme. Kjo mund të vijë kur trupi ka nevojë për më shumë vitamina (si gjatë barrës, pas një pune të rëndë, veprimtari sportive...), përveç edhe marrjes jo normale të vitaminave.

Një situatë e tillë krijohet edhe kur ka sëmurje të organeve tretëse (si psh inflamacion i zorrëve), ose prishje të funksioneve të tyre (psh në rast pirje antibiotikësh) që pengojnë absorbimin apo formimin e vitaminave. Vitaminat e

krijua në mënyrë sintetike shpesh nuk janë në gjëndje të plotësojnë nevojat e organizmit për vitamina. Nga ana tjetër duhet thënë, që në qoftë se nuk pimë sasinë e nevojshme të ujit, atëhere edhe vitaminat e tretshme në ujë nuk e japin efektin e plotë. Marrja e vitaminave në vlera optimale dhe në mënyrën e duhur vjen nga konsumimi i frutave dhe zarzavateve natyrale e të freskëta dhe nga ushqyerja e ekuilibruar.

Duhet të kemi parasysh se produktet ushqimore të mjekësisë „moderne” të prodhuara me kimikate nuk përmbajnë kurrsesi lëndët ushqyese dhe vitaminat e mëparshme.

Nuk duhet harruar gjithashtu fakti që mjedisi ynë bëhet gjithnjë e më i ndotur, bëjmë një jetë të çrregullt (me duhan, alkol, mungesë lëvizje...), gjë që rrit nevojën për vitamina. Po kështu edhe produkteve të freskëta mund tu ulet në mënyrë të konsiderueshme përmbajtja e vitaminave në qoftë se skuqim tepër. Prandaj nga faktorët e pafavorshëm të përmendur më lartë, gjithnjë e më tepër bëhet e nevojshme që organizmit këto mungesa tia sigurojmë me plotësues vitaminoz.

Mungesa e plotë e vitaminave, sot vetëm në rrethana ekstreme mund të çojë në **avitaminosis**. Ndërsa teperimi i vitaminave apo **hypervitaminosis** mund të krijohet kur ka tepëri vitaminash që treten në yndyrna, sepse vitaminat që lidhen me yndyrnat nuk mund të jashtëqiten, sikurse ndodh me vitaminat që treten në ujë.

### VITAMINA A (RETINOL)

Roli i saj: Në radhë të parë ajo ka funksionin e mbrojtjes të cipës të lëkurës (pra ka të bëjë me gjithë trupin tonë). Përmirëson shikimin. Shkurton format e sëmundjeve. Rrit aftësinë rezistuese të rrugëve të frymëmarrjesndaj infeksioneve. Forcon kokcat dhe shpejton rritjen. Luan rol për ruajtjen e flokëve, lëkurës dhe dhëmbëve.

Mungesa e saj shkakton: shikim të mjergullt, venitje të pëllhurës të lëkurës (tharje e lëkurës, trashje dhe çarje saj) sëmurje të gjendrrave (djersitje, lot, të thatë), thyerje e fijeve të flokut dhe rënie e flokëve, kalbëzim i dhëmbëve dhe tek fëmijët shqetësime të metabolizmit.

Burim i vitaminës A janë:

- vaj i mëlçisë të peshqve
- mëlçia e lopës
- e verdha e vezës
- gjalpi
- ajka e qumështit

Tek bimët ajo gjendet në karotene (karrota, spinaq, rrepa, sallata) dhe prej tyre organizmi merr vitaminën A.

Tepërimi i saj shkakton: mungesë oreksi, dhëmbje koke, rënie të lëkurës, rënie e flokëve, dhëmbje e kyçeve. Nevoja ditore: tek të rriturit 1,5 mg.

### VITAMINA B-1 (THIAMIN)

Roli i saj: Eshtë e rëndësishme për proceset e metabolizmit të karbohidrave dhe shkëmbimin e energjisë, por edhe për funksionimin e sistemit nervor, të organeve të tretjes, të

# Pasuritë e natyrës XII.

muskujeve, të mëlçisë e të zembrës. Mungesa e saj shkakton: Keqsimin e metabolizmit të karbohidrateve, lodhje, nervozizëm, dobësi, insufishencë në qarkullimin e gjakut, mungesë oreksi, depresion, harresë, dhimbje të kyçeve. Ndërsa në rast mungese të madhe shkakton sëmundjen beriberi (ngërç i muskujeve).

Burim i saj janë:

- drithërat e bluara mirë
  - krunde të llojeve të drithërave
  - maja
  - fasulet, patatet, bacilet e drithërave
  - arrët dhe llojet e lajthive
  - domatja, rrepa, kastravec, sallata, majdanozi, qepa
  - qumështi, veza, djathi, mëlçiatë
- Nevoja ditore: për të rriturit 1,2 mg

## VITAMINA B-2 (RIBOFLAVIN)

Roli i saj: në proceset e oksidimit, dekontaminimi, frymëmarrje e indevidiacióis folyamatok, méregtelenítés. Efekte ka gjithashtu në rritjen , për shumëzimin, për punën e stomakut, sistemit të zorrëve, mëlçisë dhe të sistemit nervor.

Mungesa e saj shkakton: prodhon florën e brëndshme të zorrëve por edhe për problemet e trajtimit të zgatur me antibiotikë. Simptoma të mungesës së saj janë: nervozizëm, pagjumësi, shqetësime të organeve të tretjes, depresion, dhembje koke, zbokth i flokëve, kruajtje e lëkurës dhe shqetësime të syve (kruajtje, djegje, skuqje).

Burim i kësaj vitamine janë:

- qumështi dhe produktet e tij
- veza
- mëlçitë, veshkat
- fasulet dhe llojet e zarzavateve
- majaja

Nevoja ditore: për të rriturit 1,5 mg

## VITAMINA B-3 (ACIDI NIKOTINIK)

Roli i saj: në funksionimin e sistemit nervor, në proceset e dekontaminimit, në metabolizmin e energjisë, në prodhimin e hemoglobinës, rritjen e indeve, formimin e hormoneve, për pengimin e inflamacioneve, për kondicionimin e lëkurës dhe të flokëve. Mungesa e saj shkakton: shqetësime të sistemit të zorrëve, depresion, mungesë oreksi, dhembje koke, lodhje. Ndërsa mungesa e plotë e saj shkakton sëmundjen e pellagrës.

Burim i saj janë:

- mishi, mëlçitë, veshkat
- peshku
- vezët
- majaja
- llojet e zarzavateve
- fasulet e thara
- frutat e thara (oshafe)
- drithërat e bluara mirë, embrionet e mbira

Nevojat ditore: për të rriturit 15-20 mg

## VITAMINA B-5 (ACID PANTOTEN)

Roli i saj: Ajo është pjesë formuese e konzimës, prandaj dhe ka roltë të rëndësishëm në procesin e plotë të metbolizmit (të karbohidrateve, proteinave, në sintezën dhe zberthimin e yndyrnave) Nxit prodhimin e hormoneve, stimulon funksionimin e trurit. Pakëson depresionin, ankthin dhe stresin.

Mungesa e saj që vjen vetëm nga një ushqyerje jo e gjithanshme shkakton: lodhje, dobësi, shqetësime të gjumit, probleme me zorrët, probleme me flokët dhe lëkurën e kokës

Burim i saj janë:

- mëlçitë, mishi i pulës
  - majaja
  - llojet e drithërave
  - djathrat
  - lule lakra, avokado
- Nevoja ditore: 6 mg

## VITAMINA B-6 (PIRIDOXIN)

Roli i saj: Ajo është e domosdoshme për formimin e ruazave të kuqe dhe luan rol në metabolizmin e aminoacideve, proteinave dhe yndyrnave esenciale. Pakësues i të vjellave.

Mungesa e saj mund të shkaktojë: anemi, inflamacion të nervave periferikë, pagjumësi, dobësim të muskujeve, rënie shpirtërore, shqetësime të organeve të tretjes, migrenë e dhembje koke.

Burim i saj janë:

- mëlçitë, peshku, mishi
- produktet e qumështit
- drithërat e bluara
- majaja
- spinaqi, bananet

Nevoja ditore: Për të rriturit 2 mg

## VITAMINA B-7 (BIOTIN; VITAMINA H)

Roli i saj: Luan rol të rëndësishëm në fitimin e energjisë nga qelizat. Si koenzimë luan rol në enzima të

tilla që rregullojnë metabolizmin e karbohidrateve dhe të lipideve. Rrit ndjeshmërinë e insulinës të qelizave. ndihmon gjithashtu për ekzemat dhe për uljen në peshë.

Mungesa e saj shkakton: Inflamacione të lëkurës, rënie të flokëve, rënie shpirtërore, lodhje, depresion, anemi, rritje të nivelit të kolisterinit.

Burim i saj janë:

- mëlçitë, veshkat
  - e verdha e vezes
  - majaja
  - farërat vajore
- Nevoja ditore: Për të rriturit 2 mg

## VITAMINA B-9 (ACID FOLIK; VITAMINË M)

Roli i saj: Eshte e domosdoshme gjatë barrës për zhvillimin e embrionit. Eshtë e domosdoshme për ruazat e kuqe e të bardha, për plazmën e gjakut. Pakëson rrezikun e infarktut të zembrës, ka efekte kundër depresionit.

Mungesa e saj shkakton: Çrregullime zhvillimi tek foshnja, mund të ulët numuri i ruazave të gjakut. Mund të shkaktojë inflamacion të gjuhës, çrregullime të stomakut dhe të zorrëve, pagjumësi e lodhje.

Burim i saj janë:

- mëlçitë
- majdanozi, lulelakra, brokoli, spinaqi, lakra, repa dhe karrota, sallata
- frutat
- majaja

Nevoja ditore: tek të rriturit 0,4 mg (tek ato që presin fëmijë: 0,6 mg)

## VITAMINA B-12 (KOBALAMIN)

Roli i saj: Ajo luan rol të rëndësishëm në formimin e ruazave të kuqe të gjakut. Ndikon në sintezën e proteinave nga organizmi. ndihmon në rritjen e fëmijve, rrit kujtesën dhe perqëndrimin e tyre. Vlen për sëmundjet që mbajnë gjatë, për inflamacionet e nervave dhe mbas lodhjes.

Mungesa e saj shkakton: anemi, lodhje, çrregullime nervore dhe zverdhje..

Burim i saj janë:

- mëlçitë, veshkat, mishi
  - vezët
  - qumështi dhe djathi
  - spinaqi e sallata
  - majaja
  - drithërat e bluara
- Nevojat ditore: 2 mikrogramm

# nature

## VITAMINA C (ACID ASKORBIK)

Roli i saj: Eshtë e nevojshme për një numur funksionesh të organizmit: ndihmon në shërimin e plagëve, hollimin e gjakut, forcon imunitetin, ka efekte antikanceroze, pakëson alergjinë e shkaktuar nga lëndët toksike, ndihmon në thithjen nga trupi të bakrit dhe hekurit, ul mundësinë e formimit të trombeve të gjakut, ndihmon në parandalimin e sëmundjeve virusale e bakteriale, ndihmon në parandalimin e osteoporozës. Mungesa e saj: Dobëson sistemin e imunitetit, rrit aftësinë e kundër infeksioneve, rrit hemofilinë dhe mungesa e saj rrit raportin e sëmurjes të zemrës dhe të sistemit të venave ndërsa mungesa e theksuar e saj mund të shkaktojë skorbutin.

Burim i saj janë:

- specat jeshile
  - zarzavatet e freskëta
  - llojet e agrumeve
- Nevoja ditore: 70-100 mg

## VITAMINA D (KALCIFEROL)

Roli i saj: Ndhmon për thithjen nga zorrët të kalciumit dhe të fosforit, duke ndikuar kështu në formimin e kockës. Jep mundësi të thithet më mirë vitamina A që ka të bëjë me shëndetin e dhëmbëve.. Nën ndikimin e diellit ajo prodhohet edhe në lëkurë. Mungesa e saj shkakton: bëhet e pamjaftueshme përmbajtja e lëndëve minerale në kocka, gjë që mund të sjellë deformim ose thyerje të kockave, të cilat pastaj shërohen me vështirësi. Mungesa e vazhdueshme mund të shkaktojë ostoporoze dhe rënie të dhëmbëve, ndërsa mungesa e theksuar tek fëmijët çon në rakitizëm. Metalet e rënda që

mbrijnë në organizëm (si psh plumbi) rritin nevojën për vitaminën D.

Burim i saj janë:

- vaji i mëlçisë peshkut
  - produktet e qumështit
  - veza
  - majaja
  - embrioni i farave të drithërave të mbira
  - këpurdha e livadheve
  - lloje të zarzavateve
- Nevoja ditore: 10 mikrogramm

## VITAMINA E (TOKOFEROL)

Roli i saj: Eshtë një antioksidant i fortë, me efekte vonimi të oksidimit që çon në plakje. Pengon formimin e trombeve. pengon lodhjen, ndihmon shërimin e plagëve dhe është penguese e inflamacioneve. Bashkë me vitaminën A mbron mushkëritë nga efektet e dëmshme të ndotjes të ajrit. Efekte pozitive ka edhe për zemrën dhe për muskujt. Rol të rëndësishëm kanë prodhimin e hormoneve seksuale. Mungesa e saj shkakton: probleme infertiliteti, anemi, plakje të parakohshme probleme me venat dhe sistemin nervor dhe dobësim të muskujve. Krahas ngrënies normale që të mos shkaktohen simptomat e këtyre duhet një dietë e përzier.

Burim i saj janë:

- vajrat bimor (vaj ulliri, vaj misri, vaj i farave të kungullit
  - lloje të zarzavateve
  - farëra vajore
  - embrioni i farave të drithërave të mbira
  - llojet e mishrave, mëlçitë
  - vezët
- Nevoja ditore: 10 mg

## VITAMINA K (MENADION)

Roli i saj: Ka rol të vecantë në vëralvadásban. Luan rol për formimin e proteinave përgjegjëse për formimin dhe ruajtjen e kockave të forta dhe të shëndetshme. Forcon sistemin e venave. Ndikim ka për mëlçinë dhe për libidet. Mungesa e saj shkakton: hemofili, shqetsime të qarkullimit të gjakut, dhe të mëlçisë .

Burimi i saj janë:

- zarzavatet
  - vajrat bimore
  - mjalti dhe poleni i bletës
  - produktet e qumështit
  - mishi i derrit dhe mëlçitë
- Nevoja ditore: 65 mikrogramm

## VITAMINA P (RUTIN)

Roli i saj: Ul aftësinë përçuese të kapilarëve. Ndhmon në thithjen e vitaminës C, mbron nga oksidimi. Forcon kapilarët.

Mungesa e saj shkakton: Mos thithjen e vitaminës C duke çuar në simptomat që vijnë nga mungesa e vitaminës C.

Burim i saj janë:

- agrumet
- trëndafili i egër, boronica
- brokoli
- frutat dhe zarzavatet

## LITARETURA

Kovács Jenő: Gyógyszertan  
Juliette Kellow: Vital vitamins  
Kerti Gábor: Vitamin ABC



**Dr. László Mezósi**  
Veteriner, mjek specialist

# OFERTAT TONA TË KRISHTLINDJES

## EXCLUSIVE COLLECTION

- 260 ALOE JOJOBA SHAMPOO
- 77 ALOE BITS PEACHES
- 14 BATH GELËE
- 311 SONYA DEEP MOISTURIZING CREAM
- 320 FOREVER ARGİ+
- 288 RELAXATION MASSAGE LOTION
- 287 RELAXATION SHOWER GEL
- 286 RELAXATION BATH SALTS GRATIS

## FAVOURITE COLLECTION

- 15 ALOE VERA GEL
- 22 ALOE LIPS
- 40 ALOE FIRST
- 28 FOREVER BRIGHT TOOTHGEL
- 67 ALOE EVER-SHIELD STICK DEO
- 198 FOREVER KIDS
- 52 ALOE ACTIVATOR FLEUR
- 68 FIELDS OF GREENS
- 61 ALOE VERA GELLY- TUBE
- 65 GARLIC-THYME
- 51 PROPOLIS CREAM-TUBE
- 286 RELAXATION BATH SALTS GRATIS

## WINTER COLLECTION

- 34 ALOE BERRY NECTAR
- 48 ABSORBENT C
- 200 ALOE BLOSSOM HERBAL TEA
- 214 FOREVER ECHINACEA
- 63 ALOE MOIST. LOTION
- 38 ALOE LIQUID SOAP
- 207 FOREVER BEE HONEY
- 27 FOREVER BEE PROPOLIS
- 286 RELAXATION BATH SALTS GRATIS



WINTER COLLECTION



EXCLUSIVE COLLECTION

KRIPË BANJE PËR DHURATË



FILXHANA TË MËDHENJ

CANTË PËR DHURATË



FAVOURITE COLLECTION



# MOSHA NUK ËSHTË PENGESË

VERONIKA SZERDAHELYI MENAXHERE

**Veronika Szerdahelyi ka punuar për pesëmbëdhjet vjet në një sipërmarrje ndërkombëtare si drejtuese e sekretarisë, ndërsa tani është pensioniste. Jeton në Budapest, ka dy fëmijë të rritur dhe tre nipër e mbesa. Ka sponsorë István Kása dhe Istvánné Kása, linja e sipërme Aranka Vágási, Miklós Berkics, József Szabó, Rex Maughan.**

## Si u lidhe me këtë biznes ?

Kam disa vjet që njihem me produktet, mi ka rekomanduar një kolege. Patën rezultat, që nga ajo kohë konsumoj xhelin, MSM-n, dhe shumë produkte të tjera. Vjet dola në pension dhe kisha dëshirë që më në fund të merresha me diçka, që nuk është me detyrim, dhe që e bëj me kënaqësi. Krejt rastësisht u takova me Editke-n (*Istvánné Kása – redak.*) ajo më foli për mundësin e biznesit. Oferta mu duk shumë tërheqse. Për njëzet e pesë vjet kam qënë grua doktori, prandaj nuk është larg meje mendimi për ruajtjen e shëndetit, dhe më pëlqen shumë të merrem me njerëzit. Jam me fat, që gjeta një punë inteligjente dhe në të njëjtën kohë të shpërblyeshme nga ana materiale, për vitet e pensionit.

## Ka nga ata, që thonë, se në periudhën e krizës është më e vështirë të ndërtohet biznes, edhe ti kështu mendon?

Fatmirsisht, ka shumë që janë në gjëndje por dhe të gatshëm për të shpenzuar për ruajtjen e shëndetit. Duhet gjetur ata njerëz, ata blerës, për të cilët shëndeti është i rëndësishëm. Biznesi duhet ndërtuar me vetëdije, duhet punuar muaj pas muaji, sepse vetëm kështu mund të arrihet niveli i menaxherit. Nëse ke arritur nivelin e supervizorit, ke pesëmbëdhjet pikë në atë muaj, por n.q.s. nuk vazhdon, atëhere përpjekjet do të shkojnë kotë. Ndërsa po ta vazhdosh seriozisht, atëhere brënda disa muajve mund të ndërtohet bazat e biznesit tënd.

## Ti se e bërë këtë?

Sponsorët e mi më ndihmuan shumë: më shpjeguan çfarë duhet të dijë, më ndihmuan të planifikoj, sepse ashtu si të gjithëve, edhe mua mu desh kohë të kuptoja sistemin. Nuk jam më e mira në planifikim, do të thoja më mirë i bëj punët mbi baza impulsive: e di, që duhet bërë, e di, që në fund do të jetë mirë. Besoj në ligjin e tërheqjes: pozitivja tërheq pozitiven. Nuk ka sekret të vërtetë, duhet punuar shumë, duhet mësuar vazhdimisht, duhet të dish se me çfarë merresh, dhe këtë duhet të dish ta thuash në mënyrë të besueshme. N.q.s. do ta bësh këtë, atëhere shtohen antarët e grupit.

## Si po ndërtohet grupi yt?

Është plotësisht i përzjerë, janë futur si nga rrethi i të njohurve ashtu edhe i të rekomanduarve. Përbërja e moshave është shumë ngjyrëshe: grupmosha e fëmijëve të mi është po aq e pranishme sa grupmosha ime. Bashkë me sponsorët e mi përfaqsojmë grupin e pensionistëve.



### Sa punon me biznesin?

Tani shumë më tepër, se më parë! Ky pozicion tashmë është i lidhur me përgjegjësin. Sa më shumë i afrohesha nivelit të manager-it, kuptova , që aq më shumë më duhej për të mësuar. Çdo ditë punoj shumë orë, telefonoj, bashkëbisedoj, mbaj korrespondencë me letra, shikoj website-n – për fat faqja në anglisht nuk paraqet për mua vështirësi. Shenja ime është shigjetari, për mua kryesore është liria, ndërsa për këtë pjesë e rëndësishme është pavarësia ekonomike. Më pëlqen edhe ajo që mund të njihem me shumë njerëz. Me numrin e prezantimeve nuk jam akoma e kënaqur, ndodh, që gjatë javës ka më shumë, por për fat të keq, ndodh edhe ashtu që nuk ka fare. Duhet të zhvillohem akoma, i pranoj me vështirësi përgjigjet negative dhe pakuptueshmërin; ato që për mua janë aq të thjeshta, për të tjerët përse nuk janë të tilla?

### Çfarë të dha ty Forever-i?

Në radhë të parë ndjehem mirë nga ana shëndetësore. Kam provuar shumë produkte dhe përdor gjithashtu, dhe e ndjej, që jam mirë. Në radhë të dytë ana materiale, sepse më duhet të plotësoj pensionin, dhe me këtë këtu ja dal mbarë.

### Për shumë vite ke jetuar jashtë, kështu që ke siguruar përvoja pune të shumta. Në çfarë ndryshon kjo veprimtari, nga ato që ke bërë deri tani?

Këtu futesh në një rreth të atillë, ku të gjithë ndihmojnë njëri-tjetrin, dhe kjo është shumë e çuditëshme. Nuk kam qënë asnjëherë në një ambient të tillë, ku njerëzit ndihmojnë njëri-tjetrin me zemërgjerësi. Një befasi tjetër e këndëshme ishte korrektësia pafund e firmës, që në çdo muaj vjen në llogarinë tënde bonusi i parashikueshëm, për këtë nuk duhet të shqetësohesh. Këtu çdo fjalë mund të besohet. Paratë as këtu nuk bien nga qielli, për ato duhet punuar, por atëhere janë të tuat së bashku me kënaqësin e suksesit.

### Në Hungari nuk është tipike, që dikush në vitet e pensionit të filloi karrierë të re. U ndesh me paragjykimet

Patjetër, sepse jemi të mbyllur në kuti: ne jemi mama, gjyshe, kështu e jetojmë jetën. Sot, këtu në ditën e suksesit pashë për herë të parë, që ia dola mbanë t'ju mbushnja mendjen fëmijve të mi, sepse e panë, që ka rezultat ajo për të cilën punoj. Ju bëj mesazh bashkëmoshatarëve të mi, që mosha nuk është pengesë, edhe një pensionist mund të ketë vendosmëri , qëllime dhe atëhere do të vijë edhe rezultati.

### Çfarë planesh ke parë të ardhmen?

Të zgjeroj grupin, të rris xhiron dhe të çoj tek sa më shumë njerëz këtë lajm të mirë, mesazhin e shëndetit. Dëshiroj të fitoj edhe para, që të mos kem problemet e përditëshme. Kam akoma dëshira dhe ëndrra, kjo nuk varet nga mosha, e jap këtë mesazh për të gjithë ata, që nuk e dinë akoma këtë. Edhe në jetën e deritanishme kam udhëtuar shumë, por kjo asnjëherë nuk është e mjaftueshme dhe në botë ka akoma shumë për të parë! Shëndet, para dhe mundësi: këto më jep mua FLP-ja.





Të nderuar Bashkpunëtorë!

Me kënaqsi ju njoftojmë se ndryshimi (Mudança) i hedhur si parrullë për vitin 2010, tashmë siç i takon ka mbërritur edhe tek shumë e sukseshmja Holiday Rally.

Ja hollësitë:

### **I. HOLIDAY RALLY NIVELI I I-RË. – NGJITU NJË SHKALLË!**

**Periudha e kualifikimit: nga 1 Janari 2012 deri në 30 Prill.**

**Kush kualifikohet?** Çdo distributor i ri si dhe çdo distributor i vjetër që në krahasim me nivelin ekzistues, ngjitet një shkallë më lartë në planin e marketingut (nga niveli i distributorit mund të fitosh të drejtën e pjesmarrjes vetëm në qoftë se kualifikohesh si Supervizor  
Mund të marrin pjesë në këtë program edhe të rikualifikuarit!

#### **Cilat do të jenë kushtet e nevojshme për këtë program stimulum?**

Ngjit nivelin! Gjatë periudhës të kualifikimit duhet të jesh Aktiv (duke bërë 4 pikë, nga të cilat 1 pikë të jetë blerje në emrin e vet) që nga muaji i parë; domethënë në qoftë se je regjistruar në 15 Janar 2012, atëhere duhet plotësuar qenia aktive që nga 1 Shkurti. Në krahasim me nivelin tënd ekzistues duhet që në planin e marketingut të ngjitesh një shkallë (ata që janë në nivel distributori duhet të arrijnë nivelin supervizor). Ky është niveli i I-rë i Holiday Rally-it.

Pas kualifikimit, deri në fund të periudhës të kualifikimit përsëri duhet të plotësosh në dy muaj të njëpasnjëshëm kushtet e kualifikimit, domethënë për shembull nga niveli i distributorit ose asistent supervizorit arrite nivelin supervizor në Mars, atëhere krahas ruajtjes të qënies aktive, xhiroja jote e marsit dhe prillit të marra së bashku dhe prilli me majin bashkë duhet të jenë përsëri 25 pikë. Në qoftë se nisë nga shkalla e supervizorit dhe dhe arrite shkallën asistent menaxher në mars, atëhere krahas ruajtjes të qënies aktive, xhiroja jote e marsit dhe prillit së bashku si dhe e prillit dhe majit së bashku duhet të jetë përsëri 75 pikë dhe kështu me radhë: në kualifikimin për nivelin e II-të të programit Holiday Rally.

Në qoftë se je regjistruar në muajin e fundit të periudhës të kualifikimit dhe ke plotësuar kushtet e kualifikimit për Holiday Rally, atëhere në Holiday Rally nuk mund të marrësh pjesë në akomodimin e VIP-ave, por sigurisht je kualifikuar për nivelin e I-rë.

Ai që gjatë periudhës të kualifikimit ngjit dy a më shumë shkallë të planit të marketingut, ai në Holiday Rally merr pjesë në akomodimin e VIP-ave, pra ka arritur nivelin e II-të.

Bashkpunëtorët e Nivelit të I-rë, udhëtimin e tyre duhet ta mbulojnë me shpenzimet e tyre, por sigurisht mund të marrin falas shërbime të firmës.

## II. HOLIDAY RALLY NIVELI I II-TË.

**Periudha e kualifikimit: nga 1 Maj 2012. deri në 31 Gusht.**

**Kush mund të kualifikohet?** Çdo distributor i ri apo i vjetër, që nga niveli aktual ngjitet të paktën një shkallë më lartë në planin e marketingut (nga shkalla e distributorit mund të kualifikohesh vetëm në qoftë se arrin shkallën e supervizorit).

Mund të marrin pjesë edhe të risponsorizuarit !

**Cilat janë kushtet e nevojshme të kualifikimit për këtë program stimulumimi?**

Ngjit shkallën! Gjatë periudhës të jesh Aktiv (pra 4 pikë, nga të cilat 1 pikë të jetë në emrin e vetë) që nga muaji i parë i plotë, domethënë në qoftë se je regjistruar në 15 Qershor, atëherë nga 1 Korriku. Në krahasim me nivelin tënd ekzistues duhet që në planin e marketingut të ngjitesh një shkallë (ata që janë në nivel distributori duhet të arrijnë nivelin supervizor). Ky është Niveli i I-rë i Holiday Rally-it.

Pas kualifikimit, deri në fund të periudhës të kualifikimit përsëri duhet të plotësosh në dy muaj të njëpasnjëshëm kushtet e kualifikimit, domethënë për shembull nga niveli i distributorit ose asistent supervizorit arrite nivelin supervizor në Mars, atëherë krahas ruajtjes të qënies aktive, xhiroja jote e Qershor dhe Korrik të marra së bashku dhe Korriku me Gushtin bashkë duhet të jenë përsëri 25 pikë. Në qoftë se nisësh nga shkalla e supervizorit dhe arrite shkallën asistent menaxher në Qershor, atëherë krahas ruajtjes të qënies aktive, xhiroja jote e Qershorit dhe Korrikut së bashku si dhe e Korrikut me Gushtin së bashku duhet të jetë përsëri 75 pikë dhe kështu me radhë: në kualifikimin për nivelin e II-të të programit Holiday Rally.

Në qoftë se je regjistruar në muajin e fundit të periudhës të kualifikimit dhe ke plotësuar kushtet e kualifikimit për Holiday Rally, atëherë në Holiday Rally nuk mund të marrësh pjesë në akomodimin e VIP-ave, por sigurisht je kualifikuar për nivelin e I-rë.

Ai që gjatë periudhës të kualifikimit ngjitet dy a më shumë shkallë të planit të marketingut, ai në Holiday Rally merr pjesë në akomodimin e VIP-ave, pra ka arritur nivelin e II-të.

**Akomodimi:** në hotel me 4 yje, duke përfshirë gjithshka. Bashkpunëtorët e kualifikuar për Nivelin e II-të do të shkojnë me autobus VIP, dhe gjatë aktivitetit do tu shërbehet në bufe VIP-ash dhe nuk do të ketë pika shitje për VIP-a duke mos pritur në radhë.

Bashkpunëtorët e Nivelit të I-rë, udhëtimin e tyre duhet ta mbulojnë me shpenzimet e tyre, por sigurisht mund të marrin falas shërbime të firmës.

**Kur dhe ku do të jetë Holiday Rally?**

5-6 Tetor 2012, në Porec të Kroacisë.





FOREVER

# NutraQ10

